

SHKOLLAT PUBLIKE WORCESTER

DAVID A. SHEA
Drejtor i Atletikës

Commerce Bank Field at Foley Stadium
305 Chandler Street
Worcester, Massachusetts 01602
Phone 508-799-3081 Fax 508-799-3072

Kërkesa për Kontroll Fizik për Pjesëmarrjen në Atletikë **(Physical Exam Requirement for Participation in Athletics)**

Bordi i Drejtorëve të Shoqatës Athletike Interskolastike të Masaçusetsit votoi të Enjten, 7 Qershor 2012 për t'iu përmbajtur politikave të Departamentit të Shëndetit Publik në lidhje me kontrollin fizik të kërkuar për pjesëmarrjen në atletikë. Për të qenë në përputhje me rregulloren e shtetit, kontrollet fizike do të kërkohen **çdo trembëdhjetë muaj deri nga data e kontrollit**. Për shembull, nëse një nxënës-atlet ka një kontroll fizik të datës 14 shtator 2011, ky kontroll do të skadojë më 14 tetor 2012. Do të thotë që nga 15 tetori 2012, nxënësi-atlet bëhet i papërshtatshëm për t'u stërvitur ose garuar derisa ai të paraqesë vërtetimin e një kontrolli aktual fizik tek infermierja e shkollës ose departamenti i atletikës dhe të marrë një formular të përditësuar të lejes për të marrë pjesë në atletikë. Ky është një ndryshim nga kërkesa aktuale që mundësonte një nxënës-atlet të mbetet i përshtatshëm për të gjithë sezonin nëse kontrolli i tyre fizik ishte i vlefshëm në ditën e parë të stërvitjes/ praktikës.

Ju lutemi sigurohuni që fëmija juaj ka një kontroll fizik aktual që do të jetë i vlefshëm gjatë gjithë sezonit, ose caktoni një takim tek mjeku sa më shpejt të jetë e mundur për të pasur një kontroll fizik të përditësuar. Nuk do të ketë përjashtime nga ky rregull, dhe nuk do të ketë aprovim për shtyrje afati bazuar në një letër nga mjeku. E kuptoj që kjo mund të shkaktojë disa vështirësi në caktimin e takimeve tek mjeku dhe mbulimin nga siguracioni, kështu që po jap këtë njoftim paraprak, në mënyrë që të gjithë të jenë në përputhje me rregulloren e Departamentit të Shëndetit Publik dhe MIAA dhe të mos ndikojë në përshtatshmërinë e fëmijës suaj për pjesëmarrje.